

RREGULLORE PËR THEMELIMIN DHE PUNEN E KËSHILLIT TË PARTNERËVE

Duke u bazuar në kompetencat e përcaktuara me Statutin e Kolegjit Tempulli si dhe duke i aplikuar praktikat më të mira për sigurimin e cilësisë në Kolegjin Tempulli, Këshilli Drejtues i Kolegjit miratoi rregulloren për themelimin dhe punën e këshillit të partnerëve.

Neni 1

Qëllimi

Trupa Këshillëdhënëse e Partnerëve në tekstin e mëtejme (KP) paraqet një formë të partneritetit midis industrisë dhe Kolegjit Tempulli.

Qëllimi i KP-së është që të ndihmoj Kolegjin Tempulli në përmbushjen e misionit si dhe planifikimin strategjik të tij, nëpërmjet dhënies së këshillave relevante për çështje të rëndësishme të natyrave të ndryshme.

KP është një grup i zgjedhur i përfaqësuesve nga industria, të cilët ofrojnë udhëzime për departamentin akademik dhe profesional lidhur me çështje akademike dhe planifikim strategjik të Kolegjit Tempulli.

KP paraqet një forum ku shkëmbehen idetë dhe jepen rekomandime. KP shërben si një mjet i fuqishëm për të ndihmuar në zhvillimin akademik dhe profesional të programeve të Kolegjit Tempulli me cilësi të programeve mësimore.

KP gjithashtu mund të shërbej si një mekanizëm për mbledhjen e fondeve, duke e pasur partnerin e saj industrial, përmes aplikimit në projekte me interes të përbashkët, si dhe në shkëmbimin e librave dhe materialeve relevante të fushave të përbashkëta.

Neni 2

Fushëveprimi

Rregullorja e KP-së përcakton në mënyrë shprehimore kushtet për themelimin, administrimin si dhe koordinimin e punës së KP-së në Kolegjin Tempulli.

Neni 3

Parimet

KP përmbush një funksion të rëndësishëm strategjik në Kolegjin Tempulli. Kolegji Tempulli do të mundësoj nivele të larta të angazhimit dhe bashkëpunimit cilësor dhe aktiv, në lidhje me individët, organizatat dhe korporatat në biznes, industrisë dhe profesioneve, në përputhje të plotë me Strategjinë e Kolegjit Tempulli.

Në ndërmarrjen e këtij roli këshillëdhënës, KP e kanë të ndarë qartë dhe saktë rolin si dhe funksionin e tyre këshillëdhënës nga çështjet e menaxhimit dhe qeverisjes si kompetenca të Kolegjit Tempulli.

KP gjatë punës së përbashkët nuk ka ndonjë funksion të qartë ose të nënkuptuar të qeverisjes, monitorimit të performancës, funksion operacional ose të autoritetit menaxhues.

KP nuk është pjesë përbërëse e strukturave zyrtare të qeverisjes së Kolegjit Tempulli dhe nuk është organ i karakterit vendimmarrës.

Kolegji Tempulli dhe KP angazhohen në mënyrë pro-aktive që të zhvillojnë marrëdhënie të qëndrueshme me fusha që ndërlidhen me veprimtarinë thelbësore të Kolegjit dhe KP, duke promovuar kështu reputacionin e Kolegjit dhe KP-së për veprimtarinë e tij.

Kolegji kërkon të përfitojë nga përvoja e anëtarëve të KP-së dhe anasjelltas, për rolin e tyre të rëndësishëm në industri dhe në Kolegji.

Ndërsa nga anëtarët e KP-së pritet që të japin këshilla profesionale për Akademinë në përputhje me strategjinë e Kolegjit, por edhe të jetë i hapur për angazhimin në Kolegji nëpërmjet ligjëratave kur kjo është e nevojshme.

Anëtarët e KP-së duhet të jenë të vetëdijshëm për qëllimet strategjike të Kolegjit dhe të veprojnë në përputhshmëri të plotë me Kodin e Etikës dhe Parimet e barazisë dhe respekt reciprok.

Neni 4

Përbërja dhe anëtarësia

KP-të në nivel Kolegji parimisht do të përfshijnë midis 10 dhe 15 anëtarë, të ardhur si rezultat i marrëveshjeve të bashkëpunimit në mes Kolegjit dhe Industrisë/bizneseve dhe institucioneve.

Përfaqësuesit e Kolegjit Tempulli, në KP janë: Koordinatorët e Programeve, Drejtori i Kolegjit dhe Sekretari i Përgjithshëm i Kolegjit.

Rekomandohet fuqimisht që përfaqësuesit e jashtëm (jo akademikë) të përbëjnë të paktën 50 % e të gjithë anëtarëve, si dhe të njëjtit të kenë të paktën përgatitje superiore universitare.

Punën e KP-së e drejton udhëheqësi i KP-së, i cili zgjidhet nga anëtarët e KP-ut sipas propozimeve të tyre, në parim rotacioni, në periudhë një vjeçare (me qëllim të ruajtjes së parimit të barazisë dhe pjesëmarrjes në udhëheqje të të gjithë përfaqësuesve të KP).

Anëtarësimi në KP i siguron anëtarit, pjesëmarrje në afat tre vjeçar me një periudhë maksimale të anëtarësimit radhazi prej 5 viteve.

Neni 5

Kujdesi i duhur dhe konflikt i interesit

Komunikimin në mes të anëtarëve të KP-së, e shquan kujdesi reciprok dhe i sinqertë.

Anëtarëve u kërkohet të deklarohen në rast se perceptojnë ndonjë situatë të konflikt të mundshëm interesi gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësisve të tyre, me Kolegj ose zonën e fokusit të KP-së në përputhje me dispozitat e Kodit të sjelljes së Kolegjit.

Udhëheqësi i KP-së duhet të siguroj një regjistër të konflikt të interesave dhe procesi i zbulimit vendoset dhe implementohet nga Kolegji.

Kërkesat për administrimin e konflikt të interesave janë të precizuara shprehimisht në Kodin e sjelljes.

Neni 6

Shpërblimi

Puna e KP-së realizohet si punë vullnetare, dhe si rrjedhojë nuk ka shpërblim. Mirëpo, në rast se kemi të bëjmë në aplikim dhe fitim të projekteve të përbashkëta, atëherë kjo çështje do të specifikohet me marrëveshje të veçantë.

Neni 7

Llogaridhënia dhe konfidencialiteti

Kolegji Tempulli dhe KP janë përgjegjës për të siguruar që informacioni konfidencial i Kolegjit dhe punës së KP-së, të klasifikohet si konfidencial dhe si i tillë rrjedhimisht mbrohet me dispozitat ligjore të legjislacionit pozitiv (aplikueshëm).

Informacioni konfidencial i KP-së duhet të mbrohet dhe të ndahet vetëm me anëtarët e KP-së sipas nevojës në mënyrë që të zhvillohet në mënyrë efekte veprimtaria e punës së përbashkët.

Regjistrimet e mbledhjeve të KP dhe informacionet e KP-së, duhet të mbahen në përputhje me procedurat e Menaxhimit të Regjistrimeve, në Kolegjin Tempulli.

Koordinatori i punës së përbashkët, anëtar i Kolegjit Tempulli, parimisht Sekretari i Kolegjit ,duhet të sigurojnë që agjendat, pikat e takimit, paketat e informacionit, regjistri i konflikt të interesave, procesverbalet e nënshkruara, veprimet e akorduara dhe pjesëmarrja në takime mbahen të regjistruara. Ky funksion do të përmbushet nga koordinatori i Kolegjit.

Koordinatori është përgjegjës për përcjelljen dhe azhurnimin e informacionit për anëtarësim në KP në regjistrin qendror të paktën në periudhën gjashtëmujore.

Neni 8

Roli i Këshillit të Partnerëve

- Të veproj si një grup këshillimor i Kolegjit Tempulli për drejtimin dhe rritjen e këtij institucioni në programet e akredituara akademike, ato në procedurë të akreditimit dhe zhvillimin e kurrikulave si dhe për të ndihmuar në implementimin dhe përmirësimin e tyre.
- Të veproj si një lidhje midis profilit akademik e profesional të Kolegjit dhe partnerëve të tij industrial dhe profesional, duke ofruar një mundësi për komunikim me avancimet e industrisë apo biznesit aktual dhe profesional.

- Të identifikoj veprimet që Kolegji duhet të ndërmarrë, për të ofruar studentë me përgatitje profesionale specifike për të cilat ka nevojë industria.
- KP shërben si urë lidhëse në mes të Kolegjit dhe të dhënave të nevojshme për nevojat e industrisë për programe, si dhe përgatit sigurim të resurseve humane për ushtrim të profesionit.
- Kjo nënkupton se KP ofron rekomandime për Kolegjin, për veprimet të cilat duhet të ndërmarrë për të përmirësuar programet mësimore akademike dhe profesionale si dhe për të plotësuar nevojat e industrisë.
- Studentët fitojnë një perspektivë më të gjerë dhe përfitojnë nga mundësitë e zbatimit të dijes teorike në praktikë si element kyç si dhe ekspozimi ndaj menaxhimit të projekt në botën reale, punës ekipore dhe zhvillimit të orientuar nga klientët.
- Studentët informohen drejtpërdrejt nga përfaqësuesit industrial për të ndihmuar në zhvillimin e interesit të tyre dhe përvojën e nevojshme për të filluar punën në industri.
- Departamenti fiton nga kontributi i KP në qëllimet e Kolegjit, duke siguruar rezultatin e zhvillimit të kurrikulës dhe gradave, dhe në këtë mënyrë regjistrimin pozitiv dhe tregues mërinë e programeve të Kolegjit .
- Departamenti përfiton nga pjesëmarrja dhe kontributet të cilat mbështesin departamentet për planin strategjik afatgjatë.
- Kolegji fiton perspektivë industriale mbi ndryshimet e shpejta të së kaluarës në industrinë e informatës që ndikojnë në ndryshimet në programin mësimor dhe në shpërndarjen e objektivave në kurrikulës.

Neni 9

Përfitimet e Këshillit të Partnerëve

- Disponueshmëria e të diplomuarve të Kolegjit Tempulli, të përgatitur mirë dhe që e kuptojnë profesionin si dhe procesi i realizimit të tij.
- Mundësitë për të vlerësuar punonjësit e mundshëm përmes praktikës, projekteve bashkëpunuese dhe bashkëveprimet në procesin e mësim.
- Zhvillimi profesional i personelit të industrisë përmes mësimdhënies, mësim nxënies dhe kurrikulës së zhvillimit.

- Mundësia e integritetit të tyre në procesin mësimor, për mes organizimit të trajnimeve dhe trajtimit të temave specifike për të cilat ka nevojë kurrikulare e programit të Kolegjit Tempulli.
- Transferimi i teknologjisë përmes shkëmbimeve Industriale-Akademike, në klasë dhe praktikant në Kolegj.
- Mundësia për të përmirësuar aftësitë e të diplomuarve përmes reformës së kurrikulës, e cila reflektohet në shtimin e përfitimit të industrisë në procesin e punës.
- KP fitojnë aftësinë për të vlerësuar punonjësit e mundshëm përmes kryerjes së praktikës, pjesëmarrjes në projekte bashkëpunuese dhe ndërveprimeve në klasë.

Neni 10

Propozimet dhe Miratimi

Propozimet apo këshillat e KP i adresohen Këshilli drejtues dhe menaxhmentit të lartë të Kolegjit

KP gëzon autonominë e ndërmarrjes së iniciativës dhe mund të iniciojë ndryshimin apo plotësimin e rregulloreve të Kolegjit Tempulli në varësi nga kushtet dhe rrethanat të cilat mund të paraqiten.

KP mund të propozojë programe të reja, për të cilat ata kanë vërejtur se ka nevojë tregu i punës në Kosovë.

KP mund të propozojnë dhe bashkëpunojnë në procesin e aplikimit në projekte me interes të përbashkët.

KP po ashtu gëzon të drejtën të iniciojnë edhe propozime apo sugjerime të tjera të cilat janë në interes të përbashkët në kuptimin e rritjes së cilësisë në Kolegj dhe tregun e punës.

Propozimet miratohen me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm. Ato dorëzohen në Menaxhmentin e Kolegjit Tempulli, të cilat brenda afatit 30 ditor marrin përgjigje në formë vendimi dhe me arsyetim nga Menaxhmenti i Kolegjit Tempulli.

Neni 11

Shkarkimi

Funksioni i anëtarëve të KP, përfundon në rastet si në vijim:

- Kur nuk i ushtron funksionet e caktuara të punës,
- Kur ekziston konflikt i interesit,
- Kur nuk i respekton apo shpërfillë rregulloret e Kolegjit Tempulli,
- Kur nuk merre pjesë në takime të KP tre herë me radhë, pa ndonjë arsyetim të qëndrueshëm;
- Kur nuk i respekton dispozitat e Kodit të sjelljes.

Neni 13 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit me miratimin nga Këshilli Drejtues dhe shfaqet rregulloren me nr 026/23/ të datës 08.12.2023.

Kryetaria e Këshillit Drejtues

Dr.Sc.Ema Berisha Krasniqi



